



*VENDIM*

*Nr.97 Date 27.10.2014*

**PER LICENSIMIN E SHOQERISE OPERATORI I  
SHPERNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE SH.A NE  
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICE TE  
ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa ç, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa e, 5, pika 1 germa e, 13, 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote/te pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Operatori i Shpërndarjes se Energjisë Elektrike sh.a për Liçensimin ne Aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakice te Energjisë Elektrike

**Konstatoi:**

- Paraqitjen përgjithësisht te dokumentacionit nga Operatori i Shpërndarjes se Energjisë Elektrike sh.a siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote/te pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”,

Bordi i Komisionerëve te ERE-s

**VENDOSI :**

1. Te liçenroj ne aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakice te Energjisë Elektrike shoqërinë Operatori i Shpërndarjes se Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE) për një afat 5 vjeçar.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
Bordi i Komisionereve



2. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i Komisionerëve sipas nenit 16 te Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” , i ndryshuar.
3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje aplikuesin, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë si dhe Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Sipërmarrjes për Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**

**VENDIMIN**

*Nr. 97 Date 27.10.2014*

**PER LICENSIMIN E SHOQERISE OPERATORI I  
SHPERNDARJES TE ENERGJISE ELEKTRIKE SH.A NE  
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICE TE  
ENERGJISE ELEKTRIKE**

**Anëtarët e Bordit**

	<b>Pro</b>	<b>Kundër</b>
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____